

Ne baze te nenit 38 paragrafi 1 pika 9 e Ligjit mbi Vetqeverisjen lokale („Fleta zyrtare e Malit te Zi“ nr.2/18,24/19 dhe 38/20), nenit 58 paragrafi 1 pika 9 e Statutit të Komunes se Ulqinit („Fleta .zyrtare e Malit të Zi- dispozitat e komunes“ nr.48/19), dhe nenit 54 të Ligjit mbi pronën shtetërore të Malit të Zi, („Fleta zyrtare e Malit te Zi“ nr.21/09), Kuvendi i komunes se Ulqinit , ne mbledhjen e mbajtur me 29.07.2022, ka miratuar ,

**Vendimin për dhënien e pëlqimit Sekretariatit për mbrojtjen e pasurisë
së Komunës së Ulqinit për nënshkrimin e marrëveshjes në lëndën gjyqësore në Gjykatën
themelore të Ulqinit P.nr. 522/21**

Neni 1.

I jepet pëlqim Sekretariatit për mbrojtjen e pasurisë së Komunës së Ulqinit për nënshkrimin e marrëveshjes në lëndën gjyqësore ne Gjykatën themelore të Ulqinit P.nr. 522/21 me përmbajtje si në vijim:

Obligohet e paditura Komuna e Ulqinit që në emër të shitjes së patundshmërisë për vitin 2020 t'ia paguaj paditësit Fondit të Kompenzimit nga Podgorica vlerën prej 93.493,20 euro edhe atë në këste :

- Vlerën prej 25.000,00 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes
- Vlerën prej 14.000,00 euro deri me 31.12.2022
- Vlerën prej 14.000,00 euro deri me 31.3.2023
- Vlerën prej 14.000,00 euro deri me 30.06.2023
- Vlerën prej 14.000,00 euro deri me 30.09.2023
- Vlerën prej 12.493,00 euro deri me 31.12.2023

Obligohet Komuna e Ulqinit që paditësit t'ia kompenzoj kosmos e procedurës në afat prej 15 ditësh nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes.

Në rast se Komuna e Ulqinit vonon në rastin e pagimit të obligimeve të dy kësteve të njëpasnjëshme, paditësi është i autorizuar që në mënyrë të dhunshme ta bëjë pagesën e tërë borxhit nëpërmjet Organeve kompetente.

Me këtë marrëveshje përfundojnë të gjitha obligimet dhe detyrat për këtë çështje dhe paditësi heq dorë nga kamatat prej me 31.12.2020.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë prej ditës se shpalljes ne „Fletoren zyrtare te Malit te Zi – dispozitat e komunes“.

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Numër: 02– 016/22-228-5
Ulqin , më 29.07.2022.

K R Y E T A R I
Ardijan Mavriq, d.v.